



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

**Nr. 10, date 30.1.2018**

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN E FAMILJEVE NË  
NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE ME FOND DERI NË  
6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DHE /OSE  
ME FONDET E BUXHETIT VENDOR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.1.2018, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të neneve 24, 54 shkronja “k”, 55 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, VKM nr. 955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 17.2.2017 “Mbi zbatimin e VKM nr. 955, datë 7.12.2016”, Udhëzimin nr. 4, datë 17.2.2017 “Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar, pika 4 e Udhëzimit nr. 5, datë 17.2.2017 “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%”, të ndryshuar, Udhëzimin nr. 8, datë 25.2.2015 “Për planifikimin e fondeve për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar,

**V E N D O S I**

1. Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e familjeve në nevojë që do të trajtohen me fond deri në 6% nga fondi i kushtëzuar dhe/ose me fondet e buxhetit vendor, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.1.2018

Shpallur në datën 31.1.2018

**Sekretar i këshillit**

**Suel Hadri**



**Bemal BUSHATI**

Tabele nr.1 Kriteret e sistemit të pikëzimit për trajtimin me ndihmë ekonomike

<b>KRITERET E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN ME NDIHMË EKONOMIKE</b>			
Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT	DOKUMENT KONFIRMUES STATUSI
<b>A</b>	Nga lista e familjeve jo përfituese të radhitura nga sistemi i pikëzimit (regjistri elektronik kombëtar) sipas VKM nr. 955, datë 07.12.2016, " Për Përcaktimin e Kritereve, Dokumentacionit dhe Masës së Ndhmës Ekonomike" dhe kushteve social ekonomike përfitojnë:	<b>100</b>	
1	Familjet një prindërore që përfitojnë pension familjar deri në 5000 leke	16	Regjistri elektronik kombëtar
2	Familje me më shumë se 3 (tre) fëmijë nën moshë pune (18 vjeç)	15	Regjistri elektronik kombëtar
3	Familje 2 (dy) anëtarësh me moshë mbi 50 vjeç secili (pa te ardhura)	14	Regjistri elektronik kombëtar
4	Familje që kanë k/familjarin në burg apo për kurim brenda vendit	12	Vertetim nga institucioni i vuajtjes së denimit/ose nga komisioni mjeko -ligjor
5	Familje të ngujuara për gjakmarrje	11	Vertetim nga Drejtoria Rajonale e Policisë së Shtetit
6	Familje ne proces divorci	9	Vertetim nga gjykata
7	Familjet qe kanë anëtar madhor të humbur apo zhdukur dhe si të tillë nuk mund të paraqiten tek administratori në çdo tre muaj për deklarimet.	8	Vertetim/Vendim nga gjykata
8	Familjet të prekura nga fatkeqësite natyrore	8	Konfirmim nga sektori i emergjencave civile pranë bashkisë
9	Familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara apo invalid pune.	7	Kopje vendimi nga Komisioni mjeko ligjor
10	Familje jo përfituese nga listat e sistemit të pikëzimit (regjistri elektronik kombëtar) , sipas pikëve të radhitjes në rend zbritës.		Nga regjistri elektronik kombëtar


